



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.29

3 mars

2008

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i Kuvendit nr.158, datë 18.2.2008	Për dhënien e pëlqimit për emërimin e zonjës Vitore Tusha anëtare e Gjykatës Kushtetuese	1341
Vendim i Kuvendit nr.160, datë 25.2.2008	Për krijimin e nënkomisionit “Për reformën në drejtësi”	1341
Vendim i Kuvendit nr.161, datë 25.2.2008	Për emërimin e një anëtari të grupit mbikëqyrës për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë	1342
Dekret nr.5627 datë 22.2.2008	Për emërimin e Kryetarit të Kryesisë së Përkohshme të Akademisë së Shkencave	1343
Dekret nr.5629 datë 25.2.2008	Për lirimin e Komandantit të Akademisë së Mbrojtjes “Spiro Moisiu” në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes	1343
Dekret nr.5630 datë 25.2.2008	Për emërimin e Zëvendëskomandantit të Forcës së Bashkuar...	1344
Dekret nr.5631 datë 25.2.2008	Për daljen në lirim të oficerit me gradë madhore	1344
Vendim i KM nr.140, datë 13.2.2008	Për mënyrën e administrimit të pasurive të paluajtshme, të sekustruara, në kuadër të masave kundër financimit të terrorizmit	1345
Vendim i KM nr.148, datë 13.2.2008	Për përcaktimin e procedurave për blerjen e banesave, me kosto të ulët, në treg.....	1346
Vendim i KM nr.152, datë 13.2.2008	Për miratimin e kontratës së koncesionit të formës BOT, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe	

	Energjetikës dhe shoqërisë “Muso” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit “Qytezë”	1347
Vendim i KM nr.155, datë 13.2.2008	Për miratimin e fondit limit të shpenzimeve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, për vitin 2008	1356
Vendim i KM nr.156, datë 13.2.2008	Për disa ndryshime në vendimin nr.559, datë 22.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për bashkimin e disa instituteve të Akademisë së Shkencave, organizimin e tyre në Qendrën e Studimeve Albanologjike, si dhe funksionimin e kësaj qendre në periudhën kalimtare”	1357
Vendim i KM nr.158, datë 13.2.2008	Për import-eksportin e burimeve të rrezatimit jonizues në Republikën e Shqipërisë	1358
Vendim i KM nr.161, datë 3.2.2008	Për përcaktimin e kuotave të pranimit dhe të tarifës së shkollimit për studimet specializuese afatgjata, pranë Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, për vitin akademik 2007-2008	1358
Vendim i KM nr.164, datë 28.1.2008	Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime.....	1360
Udhëzim i MB nr.238, datë 8.2.2008	Për disa ndryshime në udhëzimin nr.160, datë 25.1.2007 “Për procedurat e ndalimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të mjeteve për kundërvajtje administrative”	1363
Vendim i GJK nr.4, datë 26.2.2008	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.8, datë 11.2.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; nr.18, datë 13.4.2005 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; nr.158, datë 31.3.2006 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën	1364
Vendim i ERE nr.23, datë 22.2.2008	Për kërkesën e shoqërisë “Albania Green Energy” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues (bllok motorë-gjeneratorë të ushqyer me biomasë të lëngshme, Shëngjin, Lezhë) si burim i rinovueshëm energjie	1366
Vendim i ERE nr.24, datë 22.2.2008	Për kërkesën e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., për kualifikimin e impianteve prodhuese (Park eolik BPGE1 dhe BPGE2, Balldren, Lezhë) si burime të rinovueshme energjie.....	1367
Vendim i ERE nr.25, datë 22.2.2008	Për mosfillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “WTS Energji” sh.p.k	1367
Vendim i ERE nr.26, datë 22.2.2008	Për rinovimin e licencës shoqërisë “KESH” sh.a. në aktivitetin e importit të energjisë elektrike	1368
Vendim i ERE nr.27, datë 22.2.2008	Për rinovimin e licencës së shoqërisë “KESH” sh.a. në aktivitetin e eksportit të energjisë elektrike	1368
Vendim i KQZ nr.46, datë 29.2.2008	Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar komune, komuna Paskuqan, të datës 24.2.2008	1369

Vendim i KKRT nr.668, datë 21.1.2008	Për dhënie licence për televizionin privat kombëtar “TV Top Channel”.....	1370
Kërkesë e METE nr.9296/7, datë 25.2.2008	Shpallje kërkesë për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme të tipit “tokë bujqësore” dhe “kulturave bujqësore”, që preken nga ndërtimi i qendrës së re kombëtare dispeçer dhe zyrat e reja të operatorit të sistemit të transmetimit dhe dispeçerisë qendrore Kashar.....	1370
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të vdekur të shtetases Shemsije Qazim Pema.....	1372
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Genc Sulejman Doku.	1372
	Ndreqje gabimi	1373

VENDIM
Nr.158, datë 18.2.2008

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR EMËRIMIN E ZONJËS VITORE TUSHA ANËTARE E GJYKATËS KUSHTETUESE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 125, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të nenit 111 pika 6 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr.5614, datë 11.2.2008,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Dhënien e pëlqimit për emërimin e zonjës Vitore Tusha anëtare e Gjykatës Kushtetuese në vend të zotit Kristofor Peçi, të cilit i ka mbaruar mandati.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.160, datë 25.2.2008

PËR KRIJIMIN E NËNKOMISIONIT “PËR REFORMËN NË DREJTËSI”

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 19 pika 2 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Pranë Komisionit të Përhershëm për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut krijohet nënkomisioni “Për reformën në drejtësi”.

II. Objekti i veprimtarisë së këtij nënkomisioni është përcaktimi i çështjeve dhe masave që do të përfshihen në Paktin Kombëtar për Drejtësinë, i cili do të miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë.

III. Përbërja e nënkomisionit është si më poshtë:

1. Fatos Beja	PD	Kryetar
2. Fatmir Xhafaj	PS	Zëvendëskryetar
3. Ilir Rusmali	PD	Anëtar
4. Aldo Bumçi	PD	“
5. Arben Isaraj	PS	“
6. Besnik Dervishi	PS	“
7. Arjan Madhi	PR	“
8. Spiro Peçi	PBDNJ	“
9. Spartak Braho	LSI	“

IV. Nënkomisioni “Për reformën në drejtësi” do të kryejë këto detyra:

a) Hapja e një dialogu intensiv, për të përcaktuar çështjet që meritojnë të jenë objekt i

reformës, me institucionet e sistemit të drejtësisë dhe grupet e interesit, duke kryer seanca dëgjimore me Këshillin e Lartë të Drejtësisë, Gjykatën Kushtetuese. Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, Shkollën e Magjistraturës, Avokatin e Popullit, Policinë e Shtetit, Fakultetin Juridik të Universitetit të Tiranës, Dhomën Kombëtare të Avokatisë, Komitetin Shqiptar të Helsinkit, shoqata, organizata të shoqërisë civile, universitete private etj.

b) Ngritja e grupit të ekspertëve që do të asistojnë procesin e reformës në drejtësi pranë Kuvendit të Shqipërisë.

c) Sigurimi i një mbështetjeje ndërkombëtare të grupit të ekspertëve, nëpërmjet misionëve të ekspertizës përfaqësuese të BE-së (Euralius), SHBA-së (OPDAT) dhe OSBE-së (Prezenca në Tiranë), për garantimin e implementimit të standardeve komunitare në këtë proces.

ç) Hapja e një forumi *on-line* në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë, me qëllim përfundimin e opinionëve në lidhje me çështjet e identifikuar për t'u trajtuar në Paktin Kombëtar të Drejtësisë.

d) Konsultimi me Këshillin e Ministrave për mundësitë e realizimit në kohë dhe mbështetjen buxhetore të nevojshme për realizimin e reformës në drejtësi.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.161, datë 25.2.2008

PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË GRUPIT MBIKËQYRËS PËR KONTROLLIN
FINANCIAR TË PERSONAVE JURIDIKË JOBANKARË QË KANË MARRË HUA NGA
PUBLIKU I GJERË

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 2 të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Natasha Shehu caktohet anëtare e Grupit Mbikëqyrës të kontrollit financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë, në vend të zotit Pal Metaj.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

DEKRET
Nr.5627, datë 22.2.2008

PËR EMËRIMIN E KRYETARIT TË KRYESISË SË PËRKOZHME TË AKADEMISË SË
SHKENCAVE

Në mbështetje të nenit 92 pika “g” të Kushtetutës, si dhe të pikës 1 të nenit 11 të ligjit nr.9853, datë 26.12.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë””,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Teki Biçoku emërohet Kryetar i Kryesisë së Përkohshme të Akademisë së Shkencave.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.5629, datë 25.2.2008

PËR LIRIMIN E KOMANDANTIT TË AKADEMISË SË MBROJTJES “SPIRO MOISIU” NË
KOMANDËN E DOKTRINËS DHE STËRVITJES

Në mbështetje të nenit 93 të Kushtetutës, të pikës 8 të nenit 7 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes,

DEKRETOJ:

Neni 1

Kundër Admiral Kudret Eqerem Çela, Komandant i Akademisë së Mbrojtjes “Spiro Moisiu” në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, lirohet nga kjo detyrë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.5630, datë 25.2.2008

PËR EMËRIMIN E ZËVENDËSKOMANDANTIT TË FORCËS SË BASHKUAR

Në mbështetje të nenit 93 të Kushtetutës, të pikës 8 të nenit 7 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të

Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes,

DEKRETOJ:

Neni 1

Kundër Admiral Kudret Eqerem Çela emërohet Zëvendëskomandant i Forcës së Bashkuar.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.5631, datë 25.2.2008

PËR DALJEN NË LIRIM TË OFICERIT ME GRADË MADHORE

Në mbështetje të nenit 93, të pikës 3 të nenit 169 të Kushtetutës, të pikës 6 dhe 8 të nenit 7 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të germës “a” të pikës 1 të nenit 11 të ligjit nr.9171, datë 22.1.2004 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të germës “c” të pikës 3 të nenit 9 të ligjit nr.9047, datë 10.7.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes,

DEKRETOJ:

Neni 1

Gjeneral Brigade Astrit Fuat Jaupi, Komandant i Forcës Ajrore, lirohet nga kjo detyrë dhe del në lirim.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.140, datë 13.2.2008

PËR MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME,
TË SEKUESTRUARA, NË KUADËR TË MASAVE KUNDËR FINANCIMIT TË
TERRORIZMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e Ministrit të Financave,

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim rregullon çështjet, që lindin në çastin e fillimit të procedurave për vendosjen e sekuestros mbi pasuritë e paluajtshme, në mbështetje të ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.

2. Administrimi i pasurive të paluajtshme, të sekuestruara, që kanë për pronarë personat e shpallur si financues të terrorizmit, bëhet nga Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, më poshtë AAPSK, menjëherë pas vendosjes së sekuestros.

3. Inventari i pasurive të paluajtshme dhe procesverbali i marrjes në dorëzim të tyre kryhen nga një komision, i ngritur me urdhër të Ministrit të Financave, i cili ka në përbërje një administrator, të caktuar nga AAPSK-ja, një përfaqësues të autoritetit, që ka kryer sekuestrimin, dhe një përfaqësues të Ministrisë së Financave.

II. PASURITË E PALUAJTSHME

1. Pasuritë e paluajtshme të sekuestruara, u jepen në përdorim:

a) institucioneve shtetërore buxhetore, me urdhër të Ministrit të Financave, pasi të jetë lidhur një kontratë huapërdorjeje, e cila nënshkruhet nga huamarrësi dhe kryeadministratori i AAPSK-së;

b) subjekteve private, pasi të jetë lidhur një kontratë qiraje, e cila nënshkruhet nga qiramarrësi dhe kryeadministratori i AAPSK-së.

2. Vlera e kontratës së qirasë përcaktohet sipas ofertës të tregut, ndërsa mënyra dhe procedurat për dhënien me qira të pasurive të paluajtshme, të sekuestruara, përcaktohen nga Ministri i Financave.

3. Institucionet shtetërore, buxhetore, dhe subjektet private përballojnë çdo shpenzim, për pasurinë e marrë në përdorim, në formën e huapërdorjes, ose me qira.

4. Të ardhurat e krijuara nga administrimi i pasurisë së sekuestruar derdhen në llogari likuiduese, të hapura me autorizim të Ministrit të Financave, në njërën nga bankat e nivelit të dytë, në emër të AAPSK-së. Këto llogari funksionojnë dhe administrohen sipas rregullave të përcaktuara nga Ministri i Financave, në përputhje me ligjin nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.

5. Shpenzimet për administrimin e pasurisë përballohen nga llogaritë përkatëse, të përmendura në pikën 4 të këtij kreu.

6. Kur të ardhurat e krijuara nga administrimi i pasurive të paluajtshme, të sekuestruara, nuk mjaftojnë për përballimin e shpenzimeve të kryera për administrimin e tyre, diferenca mbulohet nga Buxheti i Shtetit.

7. Për pasuritë e paluajtshme, që janë në bashkëpronësi, dhe që, për shkaqe objektive, administrimi i tyre është i pamundur, administratori kërkon pjesëtimin e sendit në rrugë gjyqësore.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Vendimi nr.491, datë 30.6.2005 i Këshillit të Ministrave “Për disa çështje për sekuestrimin e pasurive të paluajtshme, në kuadër të masave kundër financimit të terrorizmit” shfuqizohet.

Kontratat e lidhura në zbatim të vendimit nr.491, datë 30.6.2005 të Këshillit të Ministrave, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, ruajnë fuqinë dhe efektet juridike.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.148, datë 13.2.2008

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR BLERJEN E BANESAVE, ME KOSTO TË

ULËT, NË TREG

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 17 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Blerja e banesave, me kosto të ulët, në treg, të bëhet në bazë të çmimit kufi, të përcaktuar si mesatare e çmimit, me të cilin janë shitur banesat në tregun e lirë.

2. Banesat me kosto të ulët, si rregull, blihen në qytete, ku çmimi i shitblerjes së tyre në treg është më i ulët ose i barabartë me koston e ndërtimit të banesave nga shteti. Në qytete të tjera, banesa me kosto të ulët mund të blihet për zgjidhjen e rasteve emergjente të strehimit. Miratimi i rasteve emergjente, kur programi zbatohet nga bashkitë, bëhet me vendim të këshillit bashkiak, ndërsa kur programi zbatohet nga Enti Kombëtar i Banesave, miratimi bëhet nga Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, me kërkesë, të motivuar dhe të miratuar, të këshillit bashkiak, vetëm për ato raste, kur në ato bashki nuk ka banesa shtetërore në ndërtim.

3. Për llogaritjen e çmimit mesatar, bashkitë i referohen çmimit mesatar të shitblerjeve të banesave në treg, që miratohet çdo vit me udhëzim të Këshillit të Ministrave, sipas llogaritjeve të Entit Kombëtar të Banesave. Brenda kufirit të përcaktuar në udhëzim, çdo bashki miraton një çmim mesatar për zona të ndryshme të qytetit, sipas metodologjisë së miratuar prej tyre.

4. Me disponimin e fondeve për blerjen e banesave, me kosto të ulët, në treg, subjekti, i cili zbaton programin, përcakton numrin dhe strukturën e apartamenteve, që mund të blihen, si dhe njofton personat, e miratuar me vendim të këshillit bashkiak, për t'u trajtuar me banesë me kosto të ulët, për ta gjetur banesën në treg, sipas çmimit kufi.

5. Personit të njoftuar i lihen jo më shumë se 3 muaj kohë për të gjetur banesën në treg. Për arsye të motivuara, ky afat mund të shtyhet edhe tre muaj të tjerë. Pas skadimit të këtij afati, strukturat, që zbatojnë programin, shpallin njoftim publik për blerjen e apartamenteve në treg. Njoftimi bëhet nëpërmjet mjeteve të informimit publik, të paktën në dy prej të përditshmeve, me tirazh më të lartë, për 15 ditë kalendarike.

6. Banesat, e identifikuar për blerje, përpara fillimit të procedurave, inspektohen, për të parë nëse plotësojnë kushtet teknike dhe higjienike, nga inspektorë të higjienës dhe inxhinierë civilë. Kur banesa do të blihet për një person me aftësi të kufizuar, ajo duhet të plotësojë normat në fuqi për personat me aftësi të kufizuara (shmangien e barrierave arkitektonike) edhe pse me fonde publike, në këto raste, mund të përballohen shpenzimet për realizimin e ndërhyrjeve minimale, si:

- a) prishja e shkallës hyrëse dhe zëvendësimi me rampe;
- b) vendosja e korrimanos në shkallë;
- c) zgjerimi i hapësirës së derës hyrëse të apartamentit;
- ç) vendosja e korrimanove në banjë.

Edhe bashkitë e vogla dhe të mesme ndihmohen me financime nga Buxheti i Shtetit për përshtatjen e banesave, në bazë të projekteve dhe preventivave.

7. Banesa mbetet në pronësi të subjektit financues deri në shlyerjen e plotë të vlerës së saj nga përfituesi. Mënyra e shlyerjes së vlerës së banesës përcaktohet nga subjekti, që ka financuar blerjen e banesave në treg. Në rast se banesat janë blerë nga Enti Kombëtar i Banesave, mënyra e shlyerjes së vlerës përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, sipas shkronjave “c” e “e”, të nenit 34/1 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar.

8. Ngarkohen bashkitë, Enti Kombëtar i Banesave dhe subjektet e tjera, që financojnë për zbatimin e programeve të blerjes së banesave me kosto të ulët, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.152, datë 13.2.2008

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË FORMËS BOT, TË LIDHUR
NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE
SHOQËRISË “MUSO” SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT “QYTEZË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21 pika 4, e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës BOT (ndërtim, operim, transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoriteti kontraktues, dhe shoqërisë “Muso” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit “Qytezë”, sipas tekstit dhe relacionit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË
NR.908 Rep.
NR.253 Kol.

KONTRATË KONCESIONI
E FORMËS “BOT” (NDËRTIM - OPERIM - TRANSFERIM)
PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT QYTEZË

Në Tiranë, më datë 30, muaji janar, viti 2008 (dy mijë e tetë), u paraqitën para meje notere Mimoza Shehu, e regjistruar në Dhomën e Noterisë Tiranë, me adresë “A.Frashëri”, Pallati 3/3

Palët Kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, përcaktuar si “Autoritet Kontraktues” me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.133, datë 14.3.2007 “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për ndërtimin me koncesion të hidrocentralit “Qytezë”, që më poshtë do të quhet i tillë, përfaqësuar me autorizimin nr.5580, datë 21.1.2007 nga z.Kristo Rodi, i biri i Stefanit, i datëlindjes 11.6.1957, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga letërnjoftimi NF nr.489018.

dhe

Shoqërisë “Muso” sh.p.k., regjistruar si person juridik me vendimin nr.3248, datë 31.3.1994 të

Gjykatës së Rrethit Tiranë, që më poshtë do të quhet “Koncesionari”, përfaqësuar nga administratori z.Pëllumb Muso, i biri i Zihnisë, i datëlindjes 14.8.1957, banues në Bilisht, për identitetin e të cilit u sigurova nga pasaporta QH 256383, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Hyrje

Duke pasur parasysh që Qeveria e Shqipërisë:

1. I ka dhënë një rol prioritar prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike nëpërmjet ndërtimit të hidrocentraleve të reja ose rehabilitimit të hidrocentraleve ekzistuese me anë të procedurave të koncesionit, për përmirësimin e treguesve teknikë dhe ekonomikë të rrjetit elektrik kombëtar;

2. Konsideron ndërtimin e hidrocentraleve si një element të rëndësishëm të politikës së zhvillimit të sektorit të energjisë;

3. Vlerëson formën “BOT” të koncesionit, si një formë koncesioni që bën të mundur stimulimin e investitorëve privatë për ndërtimin e hidrocentraleve të reja me anën e kapitalit privat;

4. Është e angazhuar për krijimin dhe zhvillimin e tregut të brendshëm të energjisë elektrike brenda vendit;

5. Mirëpret investitorët vendas ose të huaj në ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike.

5.1 Legjislacioni në fuqi rregullon dhënien me koncesion të hidrocentraleve dhe me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.133, datë 14.3.2007 “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për ndërtimin me koncesion të hidrocentralit “Qytezë”” autorizohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për negociimin dhe nënshkrimin e kontratës së koncesionit.

Koncesionari:

1. Është i interesuar të investojë në ndërtimin e hidrocentralit “Qytezë”, komuna Miras, rrethi Devoll, me qëllim prodhimin e energjisë elektrike dhe rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike të zonës.

2. Shoqëria “Muso” sh.p.k. zotëron kapacitetet e nevojshme tekniko-financiare për të realizuar projektin e miratuar sipas objektit të kësaj marrëveshjeje.

3. Ka kryer studimin tekniko-ekonomik dhe mjedisor për ndërtimin dhe shfrytëzimin e hidrocentralit “Qytezë”, objekt i këtij koncesioni.

4. Zotëron aftësitë drejtuese, financiare dhe teknike të kërkuara, si dhe aftësitë për të plotësuar këtë iniciativë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Neni 1

Përkufizime

Kudo që në këtë Marrëveshje përdoren termat e mëposhtëm, ato do të kenë kuptimet përkatëse, si më poshtë vijon:

1.1 Marrëveshja e koncesionit: kjo marrëveshje dhe anekset bashkëlidhur.

1.2 Autoriteti Kontraktues: Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

1.3 Koncesionari: shoqëria “Muso” sh.p.k., me seli në qytetin e Devollit.

1.4 Hidrocentral: tërësia e objekteve që shërbejnë për prodhimin e energjisë elektrike, ku përfshihen vepra e marrjes, kanali i devijimit, baseni i presionit, tubacioni që dërgon ujin në turbina, ndërtesa e centralit, së bashku me makineritë dhe pajisjet e instaluar në të, që në rastin konkret është hidrocentrali “Qytezë”, komuna Miras, rrethi Devoll, me fuqi të instaluar 250 kW dhe prodhim të energjisë elektrike rreth 1.340.000 kWh, së bashku me të gjitha objektet që përmenden më sipër.

1.5 Kontratat: të gjitha kontratat e nënshkruara nga Koncesionari me sipërmarrësit për realizimin e punimeve.

1.6 Licencë është akti administrativ që lëshohet nga autoriteti përkatës publik për të ushtruar një veprimtari, bazuar në kritere objektive të kualifikimit.

1.7 Tarifa koncesionare: sasia e energjisë elektrike, që i ofrohet pa pagesë shtetit.

Neni 2

Objekti i koncesionit

Objekti i kësaj kontrate koncesioni është:
Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit tek Autoriteti Kontraktues, konform termave dhe kushteve të kësaj kontrate.

Neni 3 **Periudha e koncesionit**

Autoriteti Kontraktues i jep Koncesionarit me koncesion ndërtimin e hidrocentralit “Qytezë”, për një periudhë 35-vjeçare, sipas shkronjës “b” të nenit 27 të ligjit nr.9663, datë 18.6.2006 “Për koncesionet”. Kjo periudhë do të fillojë nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate.

Neni 4 **Të drejtat dhe detyrimet e Autoritetit Kontraktues**

Autoriteti Kontraktues merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

4.1 Të asistojë pranë çdo institucioni shtetëror dhe organi vendor, kur është e nevojshme, për marrjen e licencave dhe të lejeve të nevojshme për koncesion.

4.2 Të miratojë projektin e zbatimit të hidrocentralit, të përgatitur nga vetë Koncesionari. Koha e nevojshme për miratimin e projektit nuk bën pjesë në grafikun e punimeve të parashikuara në aneksin 1, bashkëlidhur.

4.3 Të kontrollojë rregullisht ecurinë e kontratës, sipas kushteve të përcaktuara në të.

4.4 Të garantojë blerjen e prodhimit të energjisë elektrike nga shoqëria KESH sh.a. për 15 vitet e para të prodhimit të energjisë elektrike.

Neni 5 **Detyrimet dhe të drejtat e Koncesionarit**

Koncesionari është i detyruar të zbatojë projektin dhe objektin e kontratës konform termave dhe kushteve të saj.

Veçanërisht Koncesionari duhet që:

5.1 brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga hyrja në fuqi e kontratës së koncesionit Koncesionari të formojë shoqërinë koncesionare, që do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe transferimin e hidrocentralit tek Autoriteti Kontraktues; Shoqëria do t'i nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore, që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare në Shqipëri, si dhe në rast transferimi të aksioneve apo pjesëve të kapitalit të saj te të tretët, duhet të marrë pëlqimin e Autoritetit Kontraktues.

5.2 të fillojë punën brenda 30 ditëve nga data e miratimit të projektit të zbatimit;

5.3 të zbatojë punimet dhe planin e investimit sipas aneksit 1 dhe aneksit 2 bashkëlidhur kontratës;

5.4 të respektojë të gjitha dispozitat ligjore shqiptare që rregullojnë veprimtarinë e shoqërisë koncesionare;

5.5 të marrë masa, me qëllim që çdo investim të jetë sipas afateve në këtë kontratë dhe me cilësinë e kërkuar;

5.6 të administrojë projektin për periudhën e koncesionit;

5.7 të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet që eventualisht mund t'i shkaktohen palëve të treta;

5.8 të mbajë të informuar Autoritetin Kontraktues për çdo rrethanë që mund të ketë ndikim në ecurinë e projektit;

5.9 në veprimtarinë e tij të zbatojë legjislacionin shqiptar në fuqi;

Të marrë masa për të garantuar kushtet teknike për punëtorët dhe të tretët, për të shmangur dëmet ndaj pronës publike dhe private, të respektojë legjislacionin në fuqi për të parandaluar çdo dëm e fatkeqësi në punë.

5.10 Koncesionari detyrohet të paguajë të gjitha shpenzimet për publikimet e bëra, si dhe ato noteriale;

5.11 të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktues projektin e zbatimit sipas grafikut të punimeve, aneksi 1, bashkëlidhur;

5.12 të zbatojë projektin për ndërtimin e HEC-it “Qytezë”, me fuqi të vendosur prej 250 kW.

Neni 6

Vlerësimi i investimeve

Mbi bazën e të dhënave të projektit, investimet që duhet të kryhen nga Koncesionari janë në vlerën totale prej 27 700 000 (njëzet e shtatë milionë e shtatëqind mijë) lekësh, nga të cilat 6 800 000 (gjashtë milionë e tetëqind mijë) lekë do të investohen në makineri e pajisje.

Vlerësimi i mësipërm mund të pësojë ndryshime të mundshme, me marrëveshje ndërmjet palëve:

- pas variantit përfundimtar të projektzbatimit;

- në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit në ndërtimin e veprës, sipas efektivitetit të ofertave.

Vlera e ndryshuar e investimit mund të jetë më e madhe se 27 700 000 (njëzet e shtatë milionë e shtatëqind mijë) lekë, por jo më e vogël se 26 315 000 (njëzet e gjashtë milionë treqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë, që përfaqëson një ndryshim të investimit në vlerën 5 % të investimit total të parashikuar.

Neni 7

Programi i punimeve

Koncesionari merr përsipër të zbatojë programin e mëposhtëm të punimeve:

7.1 Koncesionari merr përsipër të vërë në punë hidrocentralin brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga hyrja në fuqi e kontratës, sipas aneksit bashkëlidhur.

7.2 Këto afate mund të ndryshohen me marrëveshje midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit, nëse marrja e lejeve nga institucionet përkatëse është vonuar përtej kohës së rregullt procedurale për marrjen e tyre.

Neni 8

Zgjidhja e kontratës së koncesionit

8.1 Autoriteti Kontraktues ka të drejtë prishjen e kontratës së koncesionit në mënyrë të njëanshme:

- a) kur Koncesionari nuk fillon punën për 6 muaj nga data e miratimit të projektit të zbatimit;

- b) në rast të mosrealizimit të fuqisë së vendosur mbi 10% të asaj sipas projektit të propozuar nga Koncesionari;

- c) kur Koncesionari kryen transferimin, ose shitjen e kuotave pa miratim të Autoritetit Kontraktues.

8.2 Kur nga ana e Autoritetit Kontraktues provohet se gjatë periudhës së koncesionit ka shkelje të ndonjë prej pikave të përmendura në këtë kontratë, ai menjëherë ia bën të njohura këto shkelje Koncesionarit, duke prituri për një periudhë 30-ditore përgjigjen e tij, me argumentet përkatëse. Në rast mbarimi të këtij afati dhe Koncesionari nuk sjell përgjigje, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të zgjidhë kontratën.

8.3 Në rastet kur Autoriteti Kontraktues zgjidh kontratën në mënyrë të njëanshme (pika 1 e këtij neni), ai ka të drejtë të marrë vlerën e garancisë së kontratës.

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë përsipër, përkohësisht, administrimin e HEC-it për sigurimin e një shërbimi të efektshëm dhe të pandërprerë dhe, në rastin e dështimit nga Koncesionari, të përbushë detyrimet e tij kontraktuale dhe të dështimit të tij, për të rregulluar shkeljen e kontratës.

8.4 Secila palë ka të drejtë ta zgjidhë kontratën kur:

- a) përbushja e detyrimeve bëhet e pamundur për shkak të rrethanave që kanë qenë jashtë kontrollit të arsyeshëm të secilës palë;

- b) ka shkelje serioze nga pala tjetër e kur kjo palë nuk mund ta korrigjojë këtë shkelje brenda afatit kohor dhe sipas mënyrës së parashikuar në kontratën e koncesionit.

8.5 Palët kanë të drejtë ta zgjidhin kontratën e koncesionit me pëlqim të dyanshëm.

Neni 9 **Kontratat**

Me qëllim që të realizohet objekti i koncesionit, Koncesionari ka të drejtë të lidhë kontrata sipërmarrjeje.

Në të gjitha kontratat e sipërmarrjes, ose nënkontraktorët, Koncesionari është i detyruar të respektojë kushtet e kësaj kontrate.

Pavarësisht nga kontratat e mësipërme, përgjegjës para Autoritetit Kontraktues për zbatimin e rregullt të këtyre kontratave mbetet gjithmonë Koncesionari.

Me përjashtim të të drejtave dhe detyrave që i jepen Autoritetit Kontraktues në këtë kontratë, Autoriteti Kontraktues nuk do të marrë përsipër asnjë detyrim kundrejt sipërmarrësve, furnizuesve dhe të tretëve.

Koncesionari nuk ka të drejtë ta japë kontratën e koncesionit me nënkoncesion.

Neni 10 **Garancitë**

Koncesionari duhet të garantojë, për llogari të Autoritetit Kontraktues (sipas formularit të paraqitur në dokumentet e tenderit) para firmosjes së kontratës, një shumë të barabartë me 2 700 000 (dy milionë e shtatëqind mijë) lekë të vlerës totale të investimit prej 27 700 000 (njëzet e shtatë milionë e shtatëqind mijë) lekësh.

Koncesionarit i lejohet ta çngurtësojë këtë vlerë vetëm pasi të ketë marrë konfirmimin nga Autoriteti Kontraktues, brenda 30 ditëve nga realizimi i investimit dhe kryerja e testimit të veprës.

Neni 11 **Sigurimet**

Koncesionari do të sigurojë objektin gjatë gjithë periudhës së koncesionit dhe do të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktues një kopje të tij çdo vit.

Në rast se objekti i siguruar shkatërrohet ose dëmtohet për shkak të rreziqeve ndaj të cilave është siguruar, zhdëmtimet në para të marra nga Koncesionari do të përdoren për të rindërtuar, riparuar, risistemuar dhe për të rikthyer objektin në gjendje funksionale të paradëmtimit apo më mirë.

Kontraktori duhet të sigurohet për përgjegjësinë për dëme materiale dhe dëmtime trupore që mund t'u shkaktohen palëve të treta si rrjedhojë e kryerjes së punimeve të ndërtimit/montimit, si dhe gjatë funksionimit të tij.

Sigurimi do të kryhet për kufij përgjegjësie jo më të ulët se 200 000 euro për çdo ngjarje dhe 500 000 euro në vit. Pjesa e zbritshme nuk mund të jetë më e lartë se 1 000 euro për çdo ngjarje dhe 2 000 euro në vit.

Autoriteti Kontraktues do të shënohet si i bashkësiguruar në të gjitha kontratat e sigurimit.

Neni 12 **Kontrolli, raportimi, inspektimet dhe mbikëqyrja e përgjithshme**

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kontrollojë Koncesionarin gjatë gjithë periudhës së koncesionit.

Koncesionari është i detyruar që çdo muaj të raportojë me shkrim pranë Autoritetit Kontraktues realizimin e programit të investimeve në vlerë dhe në natyrë dhe më pas prodhimin e energjisë elektrike.

Autoriteti Kontraktues ruan të drejtën që gjatë periudhës së koncesionit, nëpërmjet të autorizuarve të tij, të kontrollojë objektin për të vërtetuar nëse rregullat e koncesionit po kryhen sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë.

Autoriteti Kontraktues mund të ushtrojë një mbikëqyrje të përgjithshme gjatë realizimit dhe vënies në punë, me synim që të verifikojë se ecuria e punimeve, ashtu si cilësia dhe konformiteti të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe dokumentacionit të projektit.

Në rast të shkeljeve të kontratës, konstatuar gjatë kontrollit të përgjithshëm, Koncesionari do të njoftohet me shkrim për masat që do të merren dhe detyrat që do t'i lihen, si dhe mënyrën dhe afatet e zbatimit të tyre.

Neni 13

Tarifa koncesionare dhe vlera e riinvestimit

a) Tarifa koncesionare

Tarifa koncesionare është 2 % e energjisë së prodhuar. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë ta shesë këtë sasi energjie për llogari të tij.

b) Vlera e riinvestimit

Vlera e riinvestimit është 40 % e vlerës së investimit për makineritë dhe pajisjet. Kjo vlerë do të investohet çdo 15 vjet dhe do të aktualizohet sipas indeksit të inflacionit.

Neni 14

Legjislacioni i zbatueshëm

Zbatimi dhe interpretimi i kësaj kontrate koncesioni do të bazohet në legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 15

Forca madhore

Konsiderohen ngjarje të forcës madhore katastrofat e natyrës, përmbytjet, tërmetet, lufta dhe ndërhyrja e palëve të treta që kanë fuqinë e ligjit dhe çdo ngjarje e barabartë që mund të ndikojë në objektin e kësaj kontrate, duke e bërë të pamundur përmbushjen e detyrimeve reciproke të marrëveshjes, që kanë të bëjnë me vullnetin e palëve.

Gjatë zbatimit të kontratës, në rast se verifikohen vonesa të mundshme ose mosrespektime të detyrimeve të palëve, për shkak të ngjarjeve të forcës madhore, ato nuk mund të jenë shkak për kërkesa reciproke për zhdëmtim.

Në këtë rast, kur një detyrim i kësaj kontrate do të priset ose do të hiqet si rezultat i forcës madhore, pala e dëmtuar është e detyruar të njoftojë me shkrim palën tjetër, brenda 15 ditëve, duke i treguar dhe arsyetuar shtyrjen e punimeve ose braktisjen e tyre, si dhe masat që do të merren për të parandaluar pasojat.

Kufijtë e ndërprerjes së punës dhe të shtyrjes në kohë të punimeve do të përcaktohen nga palët në një procesverbal të ngjarjes.

Neni 16

Hyrja në fuqi e kontratës së koncesionit

Kontrata e koncesionit do të hyjë në fuqi pasi të jetë miratuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”.

Neni 17

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Problemet ose mosmarrëveshjet midis palëve që kanë lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj kontrate koncesioni, nuk do të anulojnë detyrimet e palëve sipas kësaj kontrate.

Palët janë të angazhuara të zgjidhin çdo mosmarrëveshje duke u bazuar në vullnetin e mirë.

Në të kundërt, çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë kontratë koncesioni, do të zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 18

Sanksionet

Mosrespektimi i afateve dhe kushteve të kësaj kontrate, në përfundim të periudhës 15- mujore, penalizon Koncesionarin, si më poshtë:

18.1 Për shkelje të afatit të ndërtimit 0,05 % në ditë të vlerës të investimeve të munguara.

18.2 Për moskryerje të investimeve në vlerën e marrë përsipër në konkurrim, Koncesionari penalizohet me 10 % të vlerës së investimeve të parealizuar.

18.3 Për çdo ditë vonesë për fillimin e punimeve, penalizohet me 10 000 lekë.

18.4 Në rast mosrealizimi, për faj të Koncesionarit, të prodhimit të energjisë elektrike prej 1.340.000 milionë KWh/vit, Koncesionari penalizohet me 5% të vlerës së prodhimit të parealizuar për periudhën raportuese.

18.5 Për mosrealizim deri në 10% të fuqisë së vendosur sipas projektit të propozuar nga Koncesionari, ai do të penalizohet me 5% të vlerës së prodhimit të energjisë elektrike të munguar, si pasojë e zvogëlimit të fuqisë së instaluar.

18.6 Nëse mosrealizimi i fuqisë së vendosur është më shumë se 10% të fuqisë së vendosur sipas projektit të propozuar nga Koncesionari, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të prishë kontratën në mënyrë të njëanshme.

Neni 19

Bashkëpunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit

Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari janë zotuar të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të projektit.

Përveç rasteve kur bien dakord me shkrim për ndonjë formë tjetër, korrespondenca do të dërgohet me letër me postë, telegram ose fax, në adresat e mëposhtme:

Për çdo ndihmë që do t'i kërkohet Autoritetit Kontraktues nga Koncesionari, ky i fundit detyrohet të paraqesë kërkesën me shkrim për çka kërkon në zbatim të detyrimeve të kësaj kontrate.

Neni 20

Transferimi i aseteve

Me mbarimin e marrëveshjes koncesionare, qoftë si përfundim i afatit të zakonshëm, ose si një mbarim i parakohshëm i saj, asetet e koncesioneve, përfshirë çdo ndërtesë apo impiant të ndërtuar nga Koncesionari në kantierin e koncesionit, do t'i transferohen Autoritetit Kontraktues, pa shpërblim apo detyrim shtesë, subjekt i termave dhe kushteve të marrëveshjes koncesionare. Autoriteti Kontraktues ka të drejtën, por jo detyrimin, të ndërhyjë në çdo kontratë të Koncesionarit.

Neni 21

Regjistrimi i kësaj kontrate

Brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e saj, kontrata duhet të regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

AUTORITETI KONTRAKTUES
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe
Energjetikës
Përfaqësuar me autorizimin _____
datë _____ të Ministrit të Ekonomisë,
Tregtisë dhe Energjetikës
Nga z.Kristo Rodi

KONCESIONARI
Shoqëria "Muso" sh.p.k.


Përfaqësuar nga

Administratori
z.Pëllumb Muso

SHERBIMI OSE PUNE E KRYER	Kohëzgjatja në ditë
1) Lidhja e kontratës*	1
2) Përgatitja e dokumentacionit	30
3) Përgatitja e projektit preventivave të zbatimit	60
4) Ngritje kantieri dhe punime parapregatitore	30
5) Ndërtimet në veprimet e marrjes	90
6) Ndërtimet në kanal dhe derivacionit	120
7) Ndërtimet në basen dhe presionit të shkarkues	60
8) Ndërtimet në tubacionin e presionit	60
9) Ndërtimet në ndërtuesin e hidrocentralit	60
10) Punime elektrike dhe montimi i makineri e pajisje	90
11) Prova teknike dhe lëshimi në punë	60

*Shënim: Programi i punimeve spastrohet në varësi të datës së marrjes së lejeve për ndërtimin.

GRAFIKU I PUNIMEVE PER NDERTIMIN E HIDROCENTRALIT "QYTEZE"



Preventivi paraprak

Objekti : HEC-i i QYTEZE

Faza: Projekt Ide

Nr	Emertimi i punimit		Vlefte (Lekë)
1	VEPRA E MARRJES	Nenshuma 1	1,799,366
2	KANALI DERIVACIONIT	Nenshuma 2	11,706,000
3	BASENI PRESIONIT E SHKARKUESI	Nenshuma 3	698,800
4	TUBACIONI PRESIONIT E BLOKAZHET	Nenshuma 4	578,000
5	NDERTESA DHE KANALI SHKARKIMIT	Nenshuma 5	889,500
6	PUNIME ELEKTRIKE TE FUQISE	Nenshuma 6	355,000
7	PUNIME PER MAKINERI PAJISJE	Nenshuma 7	100,000
8	PUNIME PER RRUGE NDERTIMI	Nenshuma 8	540,000
	Total nenshumat 1+2+3+4+5+6+7+8		16,666,666
	TVSH 20%		3,333,334
	SHUMA		20,000,000
9	MAKINERI E PAJISJE	Nenshuma 9	6,800,000
10	DETYRIME TE TJERA		250,000
11	STUDIM PROJEKTIM		450,000
12	DREJTIM PUNIMESH KOLAUDIM		200,000
	TOTALI		27,700,000

VENDIM

Nr.155, datë 13.2.2008

PËR MIRATIMIN E FONDIT LIMIT TË SHPENZIMEVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË
RADIO DHE TELEVISIONIT, PËR VITIN 2008

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin, publik e privat, në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit limit të shpenzimeve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, për vitin 2008, në shumën prej 74 400 000 (shtatëdhjetë e katër milionë e katërqind mijë) lekësh, për shpenzime korente, dhe 25 300 000 (njëzet e pesë milionë e treqind mijë) lekësh, për shpenzime për investime.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.156, datë 13.2.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.559, DATË 22.8.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR BASHKIMIN E DISA INSTITUTEVE TË AKADEMISË SË
SHKENCAVE, ORGANIZIMIN E TYRE NË QENDRËN E STUDIMEVE
ALBANOLOGJIKE, SI DHE FUNKSIONIMIN E KËSAJ QENDRE NË PERIUdhËN
KALIMTARE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21 dhe 41 e vijues të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.559, datë 29.8.2007 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Bashkimin e Institutit të Arkeologjisë, Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, Institutit të Kulturës Popullore, Institutit të Historisë, Qendrës Enciklopedike Shqiptare dhe Qendrës së Studimeve të Artit dhe organizimin e tyre në qendrën ndëruniversitare “Qendra e Studimeve Albanologjike”, me statusin e personit juridik.”.

b) Paragrafi i parë i pikës 10 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Drejtori i qendrës ndëruniversitare “Qendra e Studimeve Albanologjike” propozohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, në bazë të rekomandimit të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës, dhe emërohet nga Presidenti i Republikës.”.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.158, datë 13.2.2008

**PËR IMPORT-EKSPORTIN E BURIMEVE TË RREZATIMIT JONIZUES
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 82 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 3 e 7 të ligjit nr.8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Burimet radioaktive, që do t'i nënshtrohen procedurave të import-eksportit, si dhe pajisjet dhe sistemet, ku ato inkorporohen, janë përcaktuar në listën e miratuar nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, pranë Ministrisë së Shëndetësisë.

2. Veprimet në pikat doganore për import-eksportin e burimeve të rrezatimit jonizues kryhen vetëm pasi personat, fizikë apo juridikë, të kenë paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Licencë për veprimtari import-eksporti me burime të rrezatimit jonizues, lëshuar nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi.

b) Leje për import-eksportin e burimeve jonizuese, përkatësisht:

- për burimet e kategorive 1 e 2, lëshuar nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi.

- për burimet e kategorive 3, 4 e 5 dhe të gjeneratorëve me rrezatim x, të lëshuar nga zyra për mbrojtjen nga rrezatimet;

c) certifikatën e cilësisë së gjeneratorëve me rreze x, lëshuar brenda dy viteve të fundit, nga çasti i importimit.

3. Vendimi nr.56, datë 24.2.2000 i Këshillit të Ministrave shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

**VENDIM
Nr.161, datë 3.2.2008**

**PËR PËRCAKTIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT DHE TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT
PËR STUDIMET SPECIALIZUESE AFATGJATA, PRANË FAKULTETIT TË MJEKËSISË,
TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK 2007-2008**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 34 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuota e pranimit në programet e studimeve specializuese afatgjata, pranë Fakultetit të Mjekësisë, të Universitetit të Tiranës, për vitin akademik 2007-2008, të jetë 167, e ndarë në specialitete, sipas shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Tarifa vjetore e shkollimit për studimet specializuese afatgjata, pranë Fakultetit të Mjekësisë, të Universitetit të Tiranës, të jetë 40 000 (dyzet mijë) lekë.

Studentët e shkëlqyer nuk e paguajnë tarifën e shkollimit në vitin akademik pasardhës.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shtojcë Nr.1:

Kuota e pranimit në studimet specializuese afatgjata, sipas specialiteteve, pranë Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës për vitin akademik 2007-2008.

Nr.	Kursi i specializimit	Ministria e Shëndetësisë	Ministr. e Mbrojtjes	Ministria e Drejtësisë	Kuota të lira	Shuma
1.	Alergologji	2	-	-	3	5
2.	Anatomi Patologjike	2	-	-	3	5
3.	Anestezi-Reanimacion	9	1	-	-	10
4.	Dermatologji	5	-	-	-	5
5.	Endokrinologji	6	-	-	-	6
6.	Gastroenterologji	5	-	-	-	5
7.	Hematologji	5	-	-	-	5
8.	Imazheri	4	1	-	-	5
9.	Kardiologji	5	-	-	-	5
10.	Kirurgji Maxilo-Faciale	-	1	-	4	5
11.	Kirurgji e Përgjithshme	5	1	-	-	6
12.	Lab. Klinik-Biokimik	6	-	-	-	6
13.	Mikrobiologji	4	1	-	-	5
14.	Mjek Familje	9	-	-	1	10
16.	Nefrologji	3	-	-	2	5
17.	Neurologji	5	-	-	-	5
18.	Obstetrikë -Gjinekologji	6	-	-	-	6
19.	Okulistikë	4	1	1	-	6
20.	Onkologji	3	-	-	2	5
21.	O. R. L.	5	-	-	-	5
22.	Ortopedi-Traumataologji	4	2	-	-	6
23.	Pediatri	10	-	-	-	10
24.	Psikiatri	5	-	-	-	5
25.	Reumatologji	5	-	-	-	5
26.	Sëmundje Infektive	6	-	-	-	6
						10
27.	Shëndet Publik	8	2	-	-	
28.	Terapi Stomatologjike	-	-	-	5	5
30.	Toksikologji	-	-	-	5	5
	Gjithsej	131	10	1	25	167

VENDIM
Nr.164, datë 28.1.2008

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E

VLERËSUESVE TË DËMEVE NË SIGURIME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 89 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vlerësuesi i dëmeve në sigurime licencohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për vlerësimin e dëmeve të ndodhura, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë vendim.

2. Vlerësuesi i licencuar i dëmeve, në ushtrimin e profesionit, mund të kryejë vetëm ato veprimtari dytësore, që janë në përputhje me natyrën e profesionit dhe me ligjin për konfliktin e interesave.

3. Nuk mund të licencohet si vlerësues dëmsh personi, i cili e ushtron veprimtarinë si sipërmarrës dhe drejtues kryesor i sipërmarrjes së sigurimit dhe risigurimit.

4. Licenca e vlerësuesve të dëmeve në sigurime është profesionale, individuale dhe e patjetërsueshme.

Autoriteti, në përputhje me kërkesën, arsimimin dhe kualifikimet e aplikuesit, përcakton, në licencën e vlerësuesve të dëmeve në sigurime, fushën e veprimtarisë, sipas llojeve të dëmeve:

a) vlerësues i licencuar i dëmeve materiale (motorike dhe të pronës);

b) vlerësues i licencuar i dëmeve shëndetësore.

5. Vlerësuesit e licencuar të dëmeve në sigurime regjistrohen në regjistrin përkatës, që mbahet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Në regjistër cilësohet edhe statusi i vlerësuesit, i punësuar apo i pavarur.

6. Vetëm një vlerësues i licencuar i dëmeve mund të angazhohet nga organet shtetërore, për rregullimin dhe vlerësimin e dëmeve.

7. Vlerësuesi i dëmeve në sigurime siguron në një shoqëri sigurimi përgjegjësitë profesionale ndaj palëve të treta, për rastet e shkeljeve gjatë ushtrimit të veprimtarisë, me limit 30 000 000 lekë, për një ngjarje sigurimi, dhe limit maksimal 100 000 000 lekë, për një periudhë kohore njëvjeçare.

8. Personi fizik, i cili kërkon të pajiset me licencë për të kryer veprimtarinë e vlerësuesit të dëmeve, duhet të jetë me arsim të lartë. Ai paraqet një kërkesë me shkrim pranë Autoriteti të Mbikëqyrjes Financiare, me të dhënat identifikuese, adresën e vendbanimit, adresën e selisë, ku do të ushtrojë veprimtarinë e vlerësuesit të dëmeve, sipas pikës 4 të këtij vendimi. Kërkesa për licencë shoqërohet me:

a) dokumentacionin me karakter të përgjithshëm:

i) të dhënat identifikuese;

ii) vërtetimin origjinal ose kopjen e noterizuar, që provon se ka shlyer detyrimet financiare, sipas legjislacionit në fuqi, me afat kohor jo më vonë se tre muaj nga data e dorëzimit të kërkesës;

iii) diplomën e shkollës së lartë (origjinale ose kopje e noterizuar);

iv) dokumentacionin, që vërteton përvojën në punë, sipas profesionit (CV);

v) deklaratën e interesit se do ta ushtrojë veprimtarinë në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me standardet profesionale;

vi) të paktën një letër rekomandimi.

Kërkesat sipas nënndarjes “ii” të shkronjës “a” nuk zbatohen për personin fizik, i cili aplikon për herë të parë.

b) dokumentacionin, që vërteton plotësimin e njërit prej këtyre kushteve:

i) përfundimin e studimeve të specializuara të larta në sigurime, risigurime apo të lidhura me procesin e dëmshpërblimit ose të ndërmjetësimit në sigurime;

ii) përfundimin e një kualifikimi për vlerësimin e dëmeve në sigurime, pranë një instituti trajnimi në sigurime, brenda ose jashtë vendit, me një program të njohur nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, si dhe të ketë përvojë profesionale në fushën e sigurimeve ose risigurimeve jo më pak se dy vjet.

iii) përvojë profesionale jo më pak se pesë vjet, në mënyrë të vazhdueshme, në fushën e sigurimeve ose të risigurimeve, e lidhur me procesin e vlerësimit.

c) dokumentacionin, që vërteton besueshmërinë, si:

i) dëshminë e penalitetit, e cila nuk paraqitet nga personi fizik, por verifikohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, që vërteton se aplikuesi nuk është dënuar për ndonjë krim (ekonomik ose jo);

ii) deklaratën se nuk zotëron aksione ose nuk ka lidhje biznesi, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, me shoqëritë e sigurimit;

iii) vërtetimin, i cili provon se asetet e tij nuk janë deklaruar në proces falimentimi;

iv) deklaratën noteriale, se gjatë 5 viteve të fundit, para datës së paraqitjes së aplikimit, nuk ka qenë anëtar i këshillave mbikëqyrëse apo drejtues i shoqërive, në proces falimentimi apo likuidimi.

Dokumentacioni i përcaktuar në pikën 8, shkronja “a”, nënndarjet “i” e “v”, dhe “c”, nënndarjet “ii”, “iii” e “iv”, duhet të vetëdeklarohet nga personi fizik, sipas legjislacionit në fuqi.

9. Personat juridikë, që kërkojnë të pajisen me licencë për të kryer veprimtarinë e vlerësuesit të dëmeve të kenë të paktën 70 për qind të aksioneve, vlerësues të licencuar dëmsh.

10. Personi juridik, i cili kërkon të pajiset me licencë për të kryer veprimtarinë e vlerësuesit të dëmeve, paraqet një kërkesë me shkrim pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, ku të jepen të dhëna për drejtuesit e shoqërisë, formën ligjore të shoqërisë dhe fushat, për të cilat kërkon të ushtrojë veprimtarinë e vlerësuesit të dëmeve, sipas pikës 4 të këtij vendimi.

Kërkesa për licencë shoqërohet me:

a) dokumentacionin e mëposhtëm, me karakter të përgjithshëm dhe profesional:

i) të dhëna identifikuese për drejtorin e shoqërisë dhe anëtarët e organit më të lartë drejtues;

ii) vendimin e regjistrimit në gjykatë, statusin dhe aktin e themelimit të shoqërisë (origjinal ose kopje e noterizuar);

iii) vërtetimin, se nuk është debitor ndaj organeve tatimore dhe të sigurimeve shoqërore, me afat kohor jo më vonë se tre muaj nga data e dorëzimit të kërkesës;

iv) dokumentacionin, i cili vërteton se administratori dhe çdo i punësuar i shoqërisë, që do të përfshihet drejtpërdrejt në veprimtarinë e vlerësimit të dëmit, është i diplomuar dhe ka përvojën e aftësitë profesionale, të parashikuara në shkronjën “b” të pikës 8 të këtij vendimi;

v) deklaratën e drejtuesit ligjor, se shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me standardet profesionale.

Kërkesat sipas nënndarjes “iii” të shkronjës “a” të kësaj pike, nuk zbatohen për shoqëritë, të cilat aplikojnë për herë të parë.

b) dokumentacionin që vërteton besueshmërinë:

i) dëshminë e penalitetit, që nuk paraqitet nga subjekti, por verifikohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për anëtarët e organeve drejtuese të shoqërisë, që provon se personi nuk është dënuar për ndonjë krim (ekonomik ose jo);

ii) deklaratën e drejtuesit ligjor, se shoqëria nuk zotëron aksione ose nuk ka lidhje biznesi, të drejtpërdrejta ose të tërthorta me shoqëritë e sigurimit;

iii) vërtetimin se asetet e shoqërisë nuk janë deklaruar në proces falimentimi.

Dokumentacioni i përcaktuar në shkronjat “a”, nënndarjet “i” e “v”, dhe “b”, nënndarja “ii”, më sipër, duhet të vetëdeklarohet nga personi juridik, sipas legjislacionit në fuqi.

11. Për tërheqjen e dokumentacionit dhe për pajisjen me licencë, aplikanti paguan, për llogari të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, tarifat e përcaktuara në vendimin nr.403, datë 9.6.2005 të Këshillit të Ministrave.

12. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e plotësimit të dokumentacionit, të kërkuar në këtë vendim, shprehet për dhënien ose refuzimin e licencës për ushtrim veprimtarie për vlerësues dëmi në sigurime.

13. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime rinovohet çdo 5 vjet.

14. Personi fizik apo drejtuesi dhe punonjësit e angazhuar në vlerësimin e dëmeve, të personit juridik, i cili kërkon të pajiset me licencë si vlerësues i dëmeve apo kërkon rinovimin e licencës, u nënshtrohen testimit për njohuritë në fushën e sigurimeve, sipas rregullave të miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

15. Personit, që kërkon të pajiset me licencë, i refuzohet licenca nëse:

a) nuk përmbush kërkesat e këtij vendimi;

b) nuk kalon me sukses testimin për njohuritë, sipas pikës 14 të këtij vendimi;

c) ka kryer shkelje të kuadrit ligjor në fushën e sigurimeve.

16. Vlerësuesi i dëmeve në sigurime detyrohet:

a) ta ushtrojë veprimtarinë me profesionalizëm, kujdes dhe përkushtim ndaj të siguruarve;
b) të veprojë me mirëbesim dhe ndershmëri, për respektimin e të drejtave të të siguruarve;
c) të informojë të siguruarin dhe shoqërinë e sigurimit, për vërtetësinë e vlerësimit të dëmit;
ç) të vlerësojë vetëm mbi baza objektive;
d) të mos japë informacion dhe të dhëna të rreme, të pasakta, të paqarta ose të fshehë informacion për llojet dhe hollësitë e shërbimeve, që kryhen;

dh) të mos t'i premtojë klientit avantazhe të pajustificuara financiare, që kanë lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së tij.

17. Vlerësuesi i dëmeve në sigurime nuk mund të kryejë veprimet e vlerësuesit, nëse më parë ai ka kryer ndonjë veprimtari, që ka lidhje me objektin ose ngjarjen e siguruar, nëse ajo punë është e njëjtë ose e ngjashme me ato të mbikëqyrësit, agjentit, brokerit ose këshilluesit.

18. Vlerësuesi i dëmeve në sigurime i paraqet, me shkrim, shoqërisë së sigurimit të gjithë praktikën, që argumenton dhe vërteton saktësinë e vlerësimit të dëmit.

19. Vlerësuesi i dëmeve në sigurime është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga veprimtaria e tij. Ai lirohet nga përgjegjësia nëse vërtetohet se dëmi i shkaktuar nuk ka ardhur si rezultat i ushtrimit të veprimtarisë së tij.

20. Vlerësuesi i dëmeve në sigurime është i detyruar të ruajë konfidencialitetin e të dhënave, të fakteve dhe rrethanave, që kanë të bëjnë me të siguruarit, dhe të të dhënave, me të cilat njihet gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

21. Vlerësuesi i dëmeve në sigurime u ofron të siguruarve informacionin e mëposhtëm:

a) emrin, mbiemrin dhe adresën, ku ushtron veprimtarinë;

b) dokumentin, që vërteton se është i licencuar për të ushtruar veprimtarinë e vlerësuesit të dëmeve në sigurime;

c) këshilla dhe informacion për kryerjen e një analize të drejtë, që plotëson më mirë nevojat e të siguruarit;

ç) të dhëna për mënyrën e përfitimit të shpërblimit.

22. Lista e vlerësuesve të dëmeve në sigurime, të licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, shpallet në buletin dhe në faqen zyrtare të internetit të këtij autoriteti.

23. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare mban regjistrin e vlerësuesve të dëmeve, ku evidentohen të dhënat e tyre, si dhe njofton shoqërinë e sigurimit për personat, që kanë marrë licencën.

24. Vlerësuesi i licencuar i dëmeve detyrohet të njoftojë Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, për çdo ndryshim të të dhënave, të përfshira në regjistër, në mënyrë të veçantë, falimentimin apo shpalljen në likuidim, sapo të vihet në dijeni për një fakt të tillë.

25. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare heq licencën, nëse vërteton se vlerësuesi i dëmeve në sigurime:

a) ka bërë vlerësime të gabuara dhe subjektive;

b) ka shkelur kushtet e licencimit ose kërkesat e këtij vendimi;

c) ka bërë vlerësime të pavërteta dhe shkelje të procedurave;

ç) ka bërë vlerësime, që bien në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe me standardet profesionale;

d) ka paraqitur dokumente të falsifikuara ose të rreme, për marrjen e licencës;

dh) heq dorë vullnetarisht nga licenca për ushtrimin e veprimtarisë.

26. Në rastet e heqjes së licencës, ajo depozitohet në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, brenda 30 ditëve kalendarike.

27. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare informon shoqërinë e sigurimit dhe degën e shoqërisë së huaj të sigurimit për personat, të cilëve u është hequr licenca, për të ushtruar veprimtarinë e vlerësuesit të dëmeve në sigurime.

28. Shoqata e sigurimit dhe dega e shoqërisë së huaj të sigurimit detyrohen të zgjidhin kontratën me vlerësuesit të dëmeve, kur u është hequr licenca.

29. Ngarkohet Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.238, datë 8.2.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.160, DATË 25.1.2007 “PËR PROCEDURAT E NDALIMIT, SEKUESTRIMIT DHE KONFISKIMIT TË MJETEVE PËR KUNDËRVAJTJE ADMINISTRATIVE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të nenit 201, 206, 209, 210 e 211 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, nenit 7 të ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, pikës 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.286, datë 30.5.1994 “Për administrimin e sendeve që kalojnë në dobi të shtetit nga kundërvajtjet administrative”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000, rregullores “Për zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, me propozim të Drejtorisë së Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit, me qëllim unifikimin e procedurave për sekuestrimin dhe konfiskimin e mjeteve,

UDHËZOJ:

1. Në pikën 4, pas fjalëve “nga organet e Policisë së Shtetit” të shtohen fjalët “jo më vonë se 25 ditë nga data që vendimi i organit administrativ ka marrë formë të prerë”.
2. Fjalja e parë e pikës 7 ndryshohet si më poshtë:
“Kriteret e vlerësimit dhe të kategorizimit të mjeteve janë:”
3. Pika 8 të ndryshohet si më poshtë:
“8. Për kategorizimin e mjeteve merret vendim nga “Komisioni i Vlerësimit të Mjeteve”, i cili ngrihet me urdhër të Drejtorit të Policisë së Qarkut, ku gjenden mjetet e konfiskuara, i përbërë nga:
 - a) nëndrejtori i policisë së qarkut, kryetar;
 - b) shefi i logjistikës në drejtori, anëtar;
 - c) shefi i seksionit të policisë rrugore në komisariatit e policisë, anëtar;
 - d) specialist i administratës së Rezervave të Shtetit, anëtar;
 - e) shefi i sektorit të luftës kundër trafikeve në drejtorinë e policisë së qarkut, anëtar;
 - f) specialisti i automekanikës në drejtori të policisë së qarkut, anëtar.Komisioni vendos për:
 1. mjetet që plotësojnë kushtet teknike për qarkullim.
 2. mjetet që do të trajtohen për pjesë këmbimi dhe do të bëhen objekt shitjeje.
 3. mjetet që do të shkatërrohen dhe do të bëhen objekt shitjeje për skrap.

Automjetet e sipërpërmendura kalojnë pranë Rezervave të Shtetit sipas rregullave në fuqi.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e tij edhe për mjetet e sekuestruara deri në hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani

VENDIM
Nr.4, datë 26.2.2008

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese,
Gjergji Sauli	Anëtar i “ “

Fehmi Abdiu	Anëtar	i	“	“
Kujtim Puto	Anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Plloçi	Anëtar	i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Kristofor Peçi	Anëtar	i	“	“

me sekretare Brunilda Bara, në datën 21.1.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.58/12 Akti, që i përket:

KËRKUES: GJERGJI QIRIAKO, përfaqësuar nga avokatët Myrteza Myftari dhe Fatmir Cela, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR:

PROKURORIA E PËRGJITHSHME, përfaqësuar nga prokurorja Ermira Bakalli, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr.8, datë 11.2.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; nr.18, datë 13.4.2005 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; nr.158, datë 31.3.2006 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/f, 134/g të Kushtetutës dhe ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimeve:

- Rekursi kundër vendimit të Gjykatës së Apelit është paraqitur brenda afatit 30-ditor të përcaktuar në ligj, por Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në vendimin e marrë në dhomën e këshillimit, e ka konsideruar jashtë afatit duke e privuar nga e drejta për të marrë pjesë në gjykim.

- Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda bie në kundërshtim me parimin e prezumimit të pafajësisë, pasi bazohet në dyshime të paprovuara gjyqësisht.

- Mosrespektimi i rregullave të përcaktuara në nenet 319 e 320 të Kodit të Procedurës Penale e bëjnë të pavlefshme provën e marrë nga gjykata kur ka vendosur sigurimin e saj.

- Gjykata e Apelit, edhe pse ndryshoi një vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda tërësisht të paargumentuar, vendosi përsëri deklarinimin fajtor dhe dënimin për një veprë penale të pakryer.

Në seancën plenare në Gjykatën Kushtetuese, kërkuesi e kufizoi objektin e kërkesës së tij vetëm në shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar u shpreh për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë për proces të parregullt, sepse:

- rekursi është paraqitur brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të përcaktuar në nenet 144 e 415 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilave afati fillon nga e nesërmja e shpalljes së vendimit;

- një përfundim i tillë arrihet po t'i referohemi për analogji neneve 443 e 444 të Kodit të Procedurës Civile, nga të cilat del qartë se afati i rekursit fillon nga e nesërmja e shpalljes së vendimit. Ky qëndrim mbahet dhe në vendimin nr.106, datë 27.5.2002 të Gjykatës Kushtetuese dhe vendimin nr.366, datë 11.4.2007 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kristofor Peçi, përfaqësuesit e kërkuesit dhe të subjektit të interesuar, që kërkuan shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr.8, datë 11.2.2005, ka deklaruar fajtor kërkuesin për veprën penale të parashikuar nga neni 110-a/2 i Kodit Penal dhe e ka dënuar me 16 vjet burgim.

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr.18, datë 13.4.2005, ka ndryshuar

vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë duke e deklaruar kërkesin fajtor për veprën penale të parashikuar nga neni 114/a i Kodit Penal dhe e ka dënuar me 11 vjet burgim.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.158, datë 31.3.2006, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit.

Gjatë seancës plenare kërkesi kufizoi objektin e kërkesës në shfuqizimin si antikushtetues vetëm të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Argumentet që paraqiti kërkesi kishin të bënin me faktin se rekursi është paraqitur brenda afatit ligjor të përcaktuar nga dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Gjykata e Lartë, duke mos pranuar rekursin, i ka mohuar kërkesit pjesëmarrjen në gjykim dhe i ka cenuar të drejtën e mbrojtjes. Sipas tij, gjykimi i çështjes nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në seancë plenare do t'i jepte mundësi të paraqiste pretendimet lidhur me shkeljet e lejuara në shkallët e mëparshme të gjykimit dhe realizimin e mbrojtjes sipas ligjit.

Megjithëse kërkesi dhe subjekti i interesuar kanë pretenduar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, nëpërmjet një procesi të parregullt, ka privuar kërkesin nga pjesëmarrja në gjykim dhe mbrojtja e të drejtave të tij, Gjykata Kushtetuese çmon se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në aspektin e kërkuar, është marrë në përputhje me ligjin. Nga përmbajtja e vendimit rezulton se ndaj vendimit, të Gjykatës së Apelit kanë ushtruar rekurs prokurori dhe tre të gjykuarit, përfshirë dhe kërkesin. Në pjesën hyrëse të vendimit janë pasqyruar shkaqet e rekursit të prokurorit dhe të një të dënuari, ndërsa për të dënuarin tjetër dhe kërkesin thuhet, pa përmendur shkaqet, se rekursi i bërë nëpërmjet avokatëve është paraqitur jashtë afatit ligjor. Duke iu referuar pjesës arsyetuese të vendimit del se “rekursi i paraqitur nga Prokuroria e Apelit për Krime të Rënda dhe të gjykuarit Kadri Shega, Gjergj Qiriako, Skënder Salla, nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale”. Në këto rrethana, vazhdon arsyetimi i vendimit, në bazë të nenit 433/1 të Kodit të Procedurës Penale, çmohet mospranimi i rekursit për shqyrtim.

Duke iu referuar vendimit të Gjykatës së Lartë, del se pjesa arsyetuese është në harmoni me dispozitivin në të cilin është vendosur mospranimi i rekursit të prokurorit dhe të tre të gjykuarve, përfshirë dhe kërkesin. Fakti që në pjesën hyrëse të vendimit nuk përmenden shprehimisht shkaqet e rekursit të kërkesit dhe thuhet se është paraqitur jashtë afatit, nuk rezulton në mospranimin i tij për këtë shkak. Përkundrazi, nga arsyetimi i vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë del qartë se mospranimi është vendosur për mungesë të shkaqeve ligjore, në bazë të nenit 433/1 të Kodit të Procedurës Penale.

Kërkesi, duke referuar shkakun për të cilin Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, nuk ka argumentuar në kërkesën e tij ku konsiston shkelja e kryer nga ky Kolegji. Gjykata Kushtetuese vlerëson se pavarësisht nga mospërmendja e shkaqeve të rekursit të ushtruar nga kërkesi në pjesën hyrëse të vendimit, mospranimi i tij, si për të gjithë të tjerët, është bërë për mungesë të shkaqeve ligjore, vlerësimi i të cilave është e drejtë e gjykatës që gjykon çështjen.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f e 134/g të Kushtetutës dhe nenit 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryetar: V.Kristo.

Anëtarë: F.Abdiu, Gj.Sauli, P.Plloçi, Xh.Zaganjori, K.Puto, K.Peçi, S.Berberi, S.Sadushi.

VENDIM

Nr.23, datë 22.2.2008

PËR KËRKESËN E SHOQËRISË “ALBANIA GREEN ENERGY” SHPK PËR

**KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES (BLLOK MOTORË-GJENERATORË TË
USHQYER ME BIOMASË TË LËNGSHME, SHËNGJIN, LEZHË) SI BURIM I
RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 39, pika 2 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 9, pikat 1 dhe 2 germa “a”, të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007 “Rregullores së procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, neni 15, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike “ERE”, në mbledhjen e tij të datës 22.2.2008, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Albania Green Energy” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues (bllok motorë-gjeneratorë të ushqyer me biomasë të lëngshme, Shëngjin, Lezhë) si burim i rinovueshëm energjie,

VENDOSI:

1. Kualifikimin e impianteve prodhuese (bllok motorë-gjeneratorë të ushqyer me biomasë të lëngshme, Shëngjin, Lezhë) të shoqërisë “Albania Green Energy” sh.p.k., si burim i rinovueshëm energjie.
2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta**

**VENDIM
Nr.24, datë 22.2.2008**

**PËR KËRKESËN E SHOQËRISË “BIOPOWER GREEN ENERGY” SHPK PËR
KUALIFIKIMIN E IMPIANTEVE PRODHUESE (PARK EOLIK BPGE1 DHE BPGE2,
BALLDREN, LEZHË) SI BURIME TË RINOVUESHME ENERGJIE**

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 39, pika 2, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 9, pika 1 dhe 2 germa “a”, të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007 “Rregullores së procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, neni 15, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike “ERE”, në mbledhjen e tij të datës 22.2.2008, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Biopower Green Energy”, sh.p.k. për kualifikimin e impianteve prodhuese (Park eolik BPGE1 dhe BPGE2, Balldren, Lezhë) si burime të rinovueshme energjie,

VENDOSI:

1. Kualifikimin e impianteve prodhuese (Park eolik BPGE1 dhe BPGE2, Balldren, Lezhë) të shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k. si burime të rinovueshme energjie.
2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.25, datë 22.2.2008

PËR MOSFILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “WTS ENERGJI” SHPK

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 19 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.44, datë 24.7.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, neni 15 dhe 18, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.21, datë 4.4.2007 “Rregullorja e procedurave të licencimit”, neni 10, pika 2, dhe neni 15, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 22.2.2008, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “WTS Energji” sh.p.k., për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike me nr.16, seria PV04P, të mbajtur nga kjo shoqëri,

VENDOSI:

1. Mosfillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës, për modifikimin e licencës me nr.16, seria PV04P, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.39, datë 22.7.2004, për shoqërinë “WTS Energji” sh.p.k.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, si dhe Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për përgatitjen e njoftimit për vendimin e dhënë nga ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.26, datë 22.2.2008

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SHOQËRISË “KESH” SHA NË AKTIVITETIN E
IMPORTIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 9 pika 3, nenit 13 pika 1 germa “dh”, si dhe nenit 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neni 16 të “Rregullores së procedurave të licencimit”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve me nr.21, datë 4.4.2007, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 “Rregullores së praktikës dhe procedurave të ERE-s”, neni 15, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 22.2.2008, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “KESH” sh.a., për rinovimin e licencës në aktivitetin e importit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Rinovimin e licencës së shoqërisë “KESH” sh.a. në aktivitetin e importit të energjisë elektrike.

2. Afati i vlefshmërisë së licencës të jetë 1 vit.

3. Drejtoria e Licencave dhe e Monitorimit dhe Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë me shkrim aplikuesin (Shoqërinë “KESH” sh.a.) për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.27, datë 22.2.2008

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “KESH” SHA NË AKTIVITETIN E
EKSPORTIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 9 pika 3, nenit 13 pika 1 germa “d”, si dhe nenit 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjise elektrike”, të ndryshuar, nenit 16 të “Rregullores së procedurave të licencimit”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve me nr.21, datë 4.4.2007, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 “Rregullores së praktikës dhe procedurave të ERE-s”, neni 15, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 22.2.2008, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “KESH” sh.a. për rinovimin e licencës në aktivitetin e eksportit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Rinovimin e licencës së shoqërisë “KESH” sh.a. në aktivitetin e eksportit të energjisë elektrike.
 2. Afati i vlefshmërisë së licencës të jetë 1 vit.
 3. Drejtoria e Licencave dhe e Monitorimit dhe Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë me shkrim aplikuesin (Shoqërinë “KESH” sh.a.) për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.46, datë 29.2.2008

**PËR SHPALLJEN E REZULTATIT PËRFUNDIMTAR TË ZGJEDHJEVE TË PJESSHME
PËR KRYETAR KOMUNE, KOMUNA PASKUQAN, TË DATËS 24.2.2008”**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij, të datës 29.02.2008, me pjesëmarrjen e:

Çlirim	Gjata	Kryetar
Flamur	Çato	Zëvendëskryetar
Arben	Ristani	Anëtar
Dodë	Prenga	Anëtar
Fatmir	Kumbaro	Anëtar
Klement	Zguri	Anëtar
Shkëlqim	Hysi	Anëtar

shqyrtoi çështjen me

OBJEKT: Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar komune, komuna Paskuqan, të datës 24.2.2008.

BAZA LIGJORE: Neni 2, pika 34 germa “a”, neni 29, pika 1 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

KQZ-ja pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

VËREN:

Në datën 24.2.2008, në komunën Paskuqan, u zhvilluan zgjedhjet e pjesshme për kryetarin e komunës. Në përfundim të procesit të votimit dhe numërimit të votave nga grupet e numërimit, KZQV-komuna Paskuqan miratoi tabelën përmbledhëse të rezultateve dhe me vendim shpalli fitues

z.Fatos Rexha. Kundër vendimit të KZQV-së Paskuqan, brenda afatit ligjor, nuk pati në KQZ asnjë ankim zgjedhor nga asnjë subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet e pjesshme për kryetar komune, komuna Paskuqan, të datës 24.02.2008.

Në referim të përcaktimeve të nenit 29 dhe nenit 2, pika 34, germa "a" të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpall me vendim rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në këtë zonë zgjedhore.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 2, pika 34 germa "a", nenin 29, pika 1 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

VENDOSI:

Të shpallë rezultatin e zgjedhjeve për kryetar komune, komuna Paskuqan, të datës 24.2.2008, duke shpallur fitues z.Fatos Hasan Rexha, kandidat i mbështetur nga Partia Demokratike.

**VENDIM
Nr.668, datë 21.1.2008**

**PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN PRIVAT KOMBËTAR
"TV TOP CHANNEL"**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe rregullores me kriteret "Për dhënien e licencave për transmetime televizive analoge tokësore në nivel kombëtar", Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T'i japë subjektit "Top Channel" sh.a. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kombëtar në fushën e transmetimeve analogjike tokësore për një periudhë prej 8 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen, struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Licenca me nr.049/TVL, për operatorin televiziv privat vendor "Top Channel", bëhet e pavlefshme.

4. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE
Mesila Doda (Demi)**

**KËRKESË
Nr.9296/7, datë 25.2.2008**

SHPALLJE KËRKESË PËR SHPRONËSIM ME INTERES PUBLIK

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës shpall kërkesën për shpronësim, për interes

publik, të pasurive të paluajtshme të tipit “tokë bujqësore” dhe “kulturave bujqësore” që preken nga “Ndërtimi i qendrës së re kombëtare dispeçer dhe zyrat e reja të operatorit të sistemit të transmetimit dhe dispeçerisë qendrore Kashar”.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a Tiranë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personin që preket nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet, pasurisë që dëmtohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i posaçëm i shpronësimit pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për persona, sipas listës emërore të mëposhtme.

Brenda 15-ditëve pas publikimit, personat që kanë emrin në listën emërore, kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës pranë Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË “NDËRTIMIT TË QENDRËS SË RE KOMBËTARE DISPEÇER DHE ZYRAT E REJA TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT DHE DISPEÇERISË QENDRORE KASHAR”

RRETHI : TIRANË
KOMUNA: KASHAR

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: Tokë bujqësore, arë

SHPRONËSIMI DEFINITIV												
Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. Kadast ral	Nr. Pasurisë	Sasia e sip në m²	Çmimi lekë/m²	Lloji i kulturës bujqësore	Vlera në lekë për ha	Vlera totale e kompensimit në lekë	Adresa
1	ISUF	ADEM	SULA	ARË	2105	1/16	6060	2500	Jonxhë	70000	15.192.420	Kashar
2	EMIN	ADEM	SULA	ARË	2105	1/17	14875	2500	Jonxhë	72000	37.294.600	Kashar
	TOTALI										52.487.020	

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr.3478, datë 21.12.2007, shpall të vdekur shtetasen Shemsije Qazim Pema, e datëlindjes 1.8.1966, me datë vdekjeje 30.11.1966.

KËRKESË

Shtetasja Silvana Doku, e bija e Xhemalit dhe e Pranverës, e datëlindjes 1966, banuese në Durrës, kërkon shpalljen të vdekur të bashkëshortit të saj, Genc Sulejman Doku.

KËRKUESI
Silvana Doku

Ndreqje gabimi

Në paragrafin e dytë të pikës 5 të vendimit 96, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e aktiveve, në mbulim të provigjoneve, teknike dhe matematike, dhe të kufijve maksimalë të lejueshëm të investimeve të tyre nga shoqëritë e sigurimeve”, botuar në Fletoren Zyrtare nr.19, datë 22 shkurt 2008, bëhen këto korrigjime:

- në rreshtin e parë, fjalët “...sipas shkronjës “b””, të zëvendësohen me “...sipas shkronjës “b”, të pikës 4”
- në rreshtin e dytë, data “30.2.2006” duhet të jetë “30.6.2008”.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
 Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
 Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- | | |
|--|-----------|
| 1. KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË | 600 lekë |
| 2. REGJISTRAT E NOTERISË | 1000 lekë |

BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL	210 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE	332 lekë
KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)	542 lekë
KODI CIVIL	408 lekë
KODI I PROCEDURËS CIVILE	224 lekë
KODI I PUNËS	138 lekë
KODI I FAMILJES	244 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	88 lekë
• Vendime të Gjykatës Kushtetuese	700 lekë
• Vendime të Gjykatës së Lartë	1000 lekë
• Përmbledhje legjislacioni për nëpunësin civil	200 lekë
• Përmbledhje legjislacioni në fushën e tatimeve dhe taksave	273 lekë
• Përmbledhje e legjislacionit për pasuritë e paluajtshme (Vol. I -192 lekë; Vol. II – 168 lekë, Vol. III – 185 lekë)	

Hyri në shtyp më 1.3.2008
 Doli nga shtypi më 3.3.2008

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Nënë Tereza”
 Tiranë, 2008

Çmimi 36 lekë